


Biografite e pjesëmarrësve



Saranda, Fatosi dhe Jehona Bogujevci si fëmijë me datën 28 mars të vitit 1999 e kanë përjetuar masakrën në Podujevë. Atë ditë pjesëtarët e njësisë policore "Shkorpionët" në një oborr i kanë mbledhur 19 gra, fëmijë, të moshuar dhe kanë shtënë në ta nga pushka automatike. Në këtë krim Saranda, Jehona dhe Fatosi i kanë humbur familjarët e të afërmit e tyre –nënat, motrat, vëllezërit, gjyshërit. Vetë ata kanë qenë rënd të plagosur. Gjatë gjykimit janë ballafaquar, me kryesit e kimit, pjesëtarët e njësisë policore „Shkorpionët” me ata të cilët kanë shtënë në familjarët të tyre. Kanë qenë fëmijët të parët të cilët kanë dëshmuar gjatë procesit në Gjykatë për krime lufte në ish-Jugosllavi. Gjatë luftës së tyre shumëvjeçare për drejtësi në lidhje me atë se çka iu ka ndodhur atyre, asnjëherë nuk e kanë humbur guximin për të treguar të vërtetën dhe për t’iu përkujtuar të tjerëve që vetëm me kujtimin e së keqes mund të parandalohet përsëritja. Saranda, Fatosi dhe Jehona Bogujevci merren me punime artistike dhe janë autor të ekspozitës " Bogujevci- Histori Vizuale", e dedikuar atyre të cilët kanë mbijetuar si dhe viktimave të pafajshme të luftës.



Zijo Ribić si fëmijë tetëvjeçar ka përjetuar krimin në fshatin e tij Skočiqi në Zvornik, me datën 12 korrik të vitit 1992. Pjesëtarët e njësisë "Çetnikët e Simes" atë ditë e kishin vrarë familjen e Zijes, të afërmit e tij dhe fshatarët e tjerë dhe trupat e tyre i kanë hedhur në një gropë. Zijo arriti të ikë nga gropa ku ishin hedhur 27 trupa të vrarë edhe ishte i plagosur rënd. Pranë gjykatës në Beograd në procedurën kundër pjesëtarëve çetnikët e Simes, dëshmoi për të gjithat se çka ka përjetuar dhe parë, ndër të tjera edhe për përdhunimin e motrës së tij trembëdhjetëvjeçare Zlatije Ribić e cila pastaj është vrarë me anëtarët e tjerë të familjes së Zijos. Dëshmia e tij vendosmërisht kontribuoi në vendimin e prerë me të cilin janë dënuar kryesit me burgim shumëvjeçar. Sot jeton në Tuzël, ku punon si gjellëbërës.



Igor Matijašević në vjeshtë të vitit 1991, si katërbëdhjetëvjeçar se bashku me nënën dhe vëllaun u arratis nga vendlindja Sotin pranë Vukovarit . Babai i tij,

gjyshja dhe gjyshi kishin mbetur në shtëpi . Në dhjetor të vitit 1991 pjesëtarët e Mbrojtjes Territoriale serbe dhe policia hynë në fshat . Ata vranë disa fshatarë. Të atin e Igorit e larguan nga shtëpia dhe e dërguan në një drejtim të panjohur. Igori më vonë mësoi për zhdukjen e babait nga gjyshi dhe gjyshja. Që nga kthimi i tij, në Sotin në vitin 1998, ishte angazhuar në kërkim të babait të zhdukur dhe banorëve të tjerë të zhdukur. Edhe pse ishte një ndër më të rinjët , Igori i mblodhi tërë familjet e personave të zhdukur në një shoqatë joformale të familjarëve dhe u bë përfaqësues i tyre. Gjatë gjithë këtyre viteve ka punuar pandërprerë për të zbuluar të vërtetën për fatin e personave të zhdukur në Sotin. Këtë vit, përpjekjet e tij dhanë rezultat me zbulimin e varrezës masive me mbetjet trupore të 13 fshatarëve në mesin e tyre Igori e gjeti dhe babanë e tij. Sot ai punon si ekonomist në "VUPIK ", ku dikur punonte i ati i tij. Vazhdon kërkimet në gjetjen e 18 trupave të fshatarëve të cilët ende janë të zhdukur.



Radomir Nevajda me datën 4 gusht të vitit 1995. kur kishte filluar operacioni Stuhia, ishte me familjen e tij në shtëpi në Glina. Pas granatimit të qytetit me familjen dhe të afërmit e tij shkoi në Serbi, ku u vendos në Banja të Vrajës. Pas disa ditësh, në qendër kolektive hyri policia e armatosur me pushkë automatike, të cilët e ndan Radomirin, të atin e tij dhe gjashtë burra të tjerë. I dërguan në fshatin Luq në Baranja, në kampe të njësive speciale të MPB-së, ku u nënshtrua maltretimeve dhe poshtërimit. Edhe pse gjithë kohës ishte përpjekur për të shpjeguar që është student dhe që nuk e ka kryer shërbimin ushtarak, Radomirin e dërguan në front. Pas një muaji e morri vërtetimin që ishte një student i rregullt dhe u lirua të kthehej në Serbi. Pas gjykimit disavjeçarë gjykata gjeti se shteti serb ka shkelur të drejtën e tij për lirinë dhe solli vendimin për kompensim për vuajtjet e përjetuara. Sot ai jeton dhe punon në Beograd. Ai diplomoi në fakultetin Juridik dhe në fakultetin e Edukimit.



Sudbin Musić në vitin 1992 pasi që i mbushi 18 vjet së bashku më të ëmën, valluan dhe motrat ishte arrestuar në kampin e Tërropoljes, pranë Prijedorit. Babai i tij ishte vrarë në fillim të luftës, në fushë duke punuar me fqinjët e tij. Gjatë disa muajve të burgimit, ai ishte dëshmitar i torturës, urisë dhe poshtërimit nga ana e rojeve mbi të burgosurit boshnjakë. Pas dy muajsh janë liruar nga kampi. Tre vjet pas përfundimit të luftës, ai vendosi të kthehet në Prijedor, si një nga të kthyerit të parë. Që atëherë deri sot në qytetin i cili është bërë një simbol i kujtimeve të ndaluara Sudbin më zërin e tij çdo ditë i rikujton bashkëqytetaret të tij për të keqen në të cilën ata i mbyllin sytë dhe i mëson për të vërtetën të cilën ata kishin preferuar ta harrojnë.